



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORI

Nr. 1796/2.....Prot.

Tiranë, më 24.09...2026

V E N D I M

Nr. 257 Datë 24.09 2026

PËR

**SHPLLJEN E KONKURISIT PËR PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË
PJESSHME, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË
REHABILITIMIT PRANË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË, në VKM nr. 123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës", në shkresën e Dekanit të FSHR me nr. 1796/1 prot., datë 22.09.2026, "Kërkesë për hapjen e konkursit për punësimin e 1 (një) As/Lektor me kohë të pjesshme, pranë Departamentit të Kineziologjisë, në FSHR për vitin akademik 2026-2027", Zv/ Rektori,

V E N D O S I:

Shpalljen në Web-in [http:// www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al) të procedurave të aplikimit për personelin akademik me kohë të pjesshme në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit si më poshtë :

I. DEPARTAMENTI KINEZIOLOGJISË

1 (një) Asistent Lektor

- Lënda : "Gjuhë e huaj"
- Moduli : "Gjuhë Angleze"

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për "Asistent Lektor" për Lëndën: "Gjuhë e huaj" për Modulin: "Gjuhë e Angleze" në Departamentin e Kineziologjisë janë si më poshtë:

II. KRITERE TE PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës. Ai duhet të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse

	për Arsimin në Shqipëri).
2	Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8, si dhespecialiteti i lëndës që konkuron duhet të jetë mbi 8. - Për çdo 0.1 notë më shumë se 8.00, shtohet me 0.5 pikë në vlerësim, gjithsej 10 pikë. - Përfshihen nga kërkesa vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet praktika mësimore (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
3	Të zotërojnë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht). Përfshihen nga kërkesa e pikës 5, vetëm kandidatët që rekrutohen si instruktor i certifikuar në specialitetin përkatës, në aktivitetet mësimore (outdoor), për programet e sporteve në natyrë.
4	Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë, në përputhje me normat e vendosura në përcaktimin e kriterëve të punësimit për staf akademik me kohë të plotë në UST;
5	Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale;
6	Të mos ketë prishur imazhin e UST-së;
Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.	

Kritere specifike:

1. Të ketë mbaruar studimet e larta universitare për “Gjuhë të Huaj”.
2. Duhet të zotërojnë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i Shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar.
3. Të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8-të.
4. Të ketë 2 (dy) referenca nga profesorë të fushës.

Kritere preferenciale:

1. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në IAL.
2. Vlerësohen specializime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së “Gjuhës së Huaj”.
3. Të ketë kryer aktivitete shkencore si: referime, botime brenda dhe jashtë vendit.
4. Vlerësohen dhe një nga gjuhët e Bashkimit Evropian.

➤ Vlerësimi i Intervistës:

- Në aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së filozofisë së mësimdhënies/kërkimit shkencor nga ana e kandidatit.
- Prezantimin në Power Point (ppt) dhe referimin e një teme që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë (mini – leksion/prezantin).
- Të jetë i gatshëm t’i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
- Kandidati duhet të jetë i përgatitur që mund të intervistohet edhe në gjuhën të cilën ai ka të certifikuar në aplikim.
- Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 70 pikë nga dosja dhe 30 pikë nga intervista. Kandidati duhet të marrë të paktën 21 pikë nga vlerësimi i dosjes për të kaluar në fazën e intervistës. Në rast se një nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 50 pikë (50% të pikëve totale) komisioni vendos përfundimin e procedurës së këtij kandidati pa u përzgjedhur.
- Në rast se kandidatët janë me pikë të barabarta, atëherë renditja bëhet nëpërmjet shortit.

III. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vënde pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:

- a) Formular aplikimi;
- b) Letër motivimi dhe shprehje interesi për lëndën/modulin që kandidati aplikon.
- c) Një kopje jetëshkrimi i fokusuar në eksperiencat në mësimdhënie dhe botime shkencore;
- d) Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri);
- e) Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriterëve të shpallura;
- f) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti/ formulari i vetëdeklarimit);
- h) Vërtetim nga qendra e punës për t'u angazhuar si pedagog me kohë të pjesshme në institucionin tonë. (n.q.s është i punësuar e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon. (dorëzohet nëse shpallet fitues)
- i) Librezë shëndetësore nga Qendra Shëndetësore (dorëzohet nëse shpallet fitues).

IV. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriterëve të shpallura të konkurimit në njoftimin publik, duhet të dorëzohet në adresën e përcaktuar në njoftim që është:

- Dorëzimi i dokumentacionit bëhet nëpërmjet **rrugës postare**;
- Vetëm paketat e aplikimit të mbërritura me anë të aplikimit elektronik ose shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit (dërguesi); pastaj sipas renditjes (marrësi) 1) Universiteti i Sporteve të Tiranës, 2) Njësia Kryesore, 3) Njësia bazë, 4) **specialiteti ku aplikon** (lënda), emri, mbiemri.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

V. Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit. Kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e publikimit të njoftimit dhe e dorëzon atë të mbyllur në zarf me rrugë postare.

- VI. Të pranohet si kandidaturë qoftë dhe kur paraqitet vetëm një dosje, me kusht që kandidati të plotësojë kriteret.
- VII. Deri në datën 30.09.2026, të ngrihet pranë Departamentit, Komisioni ad-hoc, i cili brenda datës 02.10.2026 duhet të vlerësojë dosjet e paraqitura. Pas shpalljes së listës me kandidatët vlerësues, afati i pritjes së ankesave është 2 (dy) ditë.
- VIII. Departamenti përkatës në bashkëpunim me Komisionin ad-hoc është përgjegjës për ruajtjen dhe arkivimin e dosjeve si dhe të kontratave të lidhura me kandidatët fitues.
- IX. Dekanati i FSHR, përcjell listën përfundimtare brenda datës 07.10.2026, për miratim në Rektorat.
- IV. Për zbatimin e Vendimit, ngarkohen: Zv.Rektori i anës mësimore, Dekani i FSHR, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtoria e Zhvillimit të

Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për shpalljen dhe hedhjen e të dhënave në *Web-in* <http://www.ust.edu.al>.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Agron KASA

NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZV/REKTORI

Prof. Dr. Dhimitraq PRIFTI

